



RREGULLORE PËR MARRËVESHJE TË BASHKËPUNITIT

Në bazë të nenit 34, të Statutit të Kolegjit Tempulli në Prishtinë, Këshilli Akademik në mbledhjen e mbajtur më 29.01.2025 miratoi rregulloren për marrëveshje të bashkëpunimit.

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo rregullore përcakton procedurat për fillimin, hartimin, përmbajtjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Kolegjit Tempulli dhe Institucioneve të tjera vendore dhe ndërkombëtare të Arsimit të Lartë, si dhe institucioneve të tjera jo-arsimore me karakter jo-akademik, por që janë me interes për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta për Kolegjin Tempulli.

Inicimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

Neni 2

Të drejtën e iniciativës për fillimin dhe përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit e kanë si më poshtë: Këshilli Akademik, Drejtori i Kolegjit, Koordinator i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare

Të gjitha procedurat për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit koordinohen nga Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Të gjitha iniciativat për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit duhet të aprovohen paraprakisht nga Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare në koordinim me Drejtorin e Kolegjit.

Hartimi dhe përmbajtja e marrëveshjeve të bashkëpunimit

Neni 3

Teksti dhe përmbajtja e projekt-marrëveshjes së hartuar nga personat kompetentë të përcaktuar në nenin e mëparshëm, i dërgohen paraprakisht Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit.

Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm harmonizon tekstin dhe përmbajtjen e projekt-marrëveshjes me qëllim të harmonizimit të çështjeve teknike dhe ligjore.

Marrëveshjet e bashkëpunimit hartohen në gjuhën: Në shqip, në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër në varësi të gjuhës zyrtare të palës tjetër.

Në të gjitha rastet, të paktën dy kopje të marrëveshjes së bashkëpunimit mbeten për Kolegjin Tempulli, njëra në Zyrën e Marrëdhënieve të Brendshme dhe tjetra në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit

Neni 4

Drejtori i Kolegjit dhe Koordinatori i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare udhëheq të gjitha aktivitetet në lidhje me lidhjen e marrëveshjeve me institucione jashtë Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, nënshkruhen nga Drejtori i Kolegjit.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione jo-akademike, të karakterit jo-akademik, nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm ose nga mekanizmat përkatës brenda akademisë siç është Instituti për Sigurinë në Rrugë dhe Trafik.

Në të gjitha rastet e marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit, zbatohet parimi i reciprocitetit.

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 5

Në rast se iniciativa për marrëveshje bashkëpunimi fillon nga Kolegji Tempulli, atëherë Drejtori i Kolegjit vendos për përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen negociatat, mbulimin e shpenzimeve dhe çështje të tjera të lidhura me to.

Në rastet kur iniciativa për marrëveshje bashkëpunimi fillon nga institucione të tjera, atëherë koordinatori i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare i paraqet informacionin bazë Drejtorit të Kolegjit dhe se miraton ose refuzon propozimin.

Në rastet kur kemi rënë dakord të bashkëpunojmë me institucione të arsimit të lartë dhe me partnerë ndërkombëtarë, në secilin rast pjesë e delegacionit është edhe koordinatori i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Përgjegjësitë e Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Neni 6

Çdo korrespondencë gjatë fazës së negociatave deri në finalizimin e marrëveshjeve bashkëpunuese me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe partnerët ndërkombëtarë, kryhet nga Koordinator i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Për çdo përparim në negociata, Koordinator i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare raporton tek Drejtori i Kolegjit .

Në bashkëpunim me Zyrën për Teknologjinë e Informacionit, Zyrën për Bashkëpunim International zhvillon një bazë të të dhënave në të cilën duhet të shënohen të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit me detaje të saj. Vetëm koordinatori i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe

zyrtari i autorizuar prej tij, kanë qasje të plotë në këtë bazë të të dhënave.

Hyrja në fuqi

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për marrëveshje bashkëpunimi nr. 12/23, dt. 10/10.2023.

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Dr. Sc. Meylan Haxhaku



